Intervistë me Kadri Veselin, ish-shef i Shërbimit Informativ të Kosovës, tash anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës

Intervistoi: Visar Duriqi & Besnik Boletini

Në regjistrin e votuesve në Prishtinë figurojnë dy persona me emrin Kadri Veseli. Preportr ka intervistuar njërin prej tyre, atë që drejtoi Shërbimin Informativ të Kosovës (SHIK) prej vitit 1999 e deri në qershor të vitit 2008, kur ja "vnoi drynin" me një deklaratë në televizionin publik.
Tash është vetëm një biznesmen që i ka hyrë politikës dhe ngjitjes zyrtare në hierarkinë e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), parti që mban pushtetin qendror që nga fundi i vitit 2007, dhe e cila që nga krijimi u drejtua nga Hashim Thaçi, dikur Drejtor Politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).
Veseli, që merret me tregtimin e pajisjeve elektronike, kryesisht kompjuterë, me kompaninë "Kobit PC", si biznes familjar, ka pranuar të ndaj me ne vetëm një pjesë të vogël të tregimit të tij se si u bë banor rezident i Prishtinës.
Ai thote se menjëherë pas lufte ka blerë një banesë në Ulpianë, nga pronar legal shqiptar. Pas krijimit të familjës së vetë, përkatesisht nga viti 2003 ka në pronësi së paku një banesë në qendër, të cilën poashtu thotë se e ka blerë nga një shqiptar, të cilit nuk do t'ia zbulojë emrin, por thotë se këtë e ka bërë pasi që është siguruar nga ish-HABITAT-i, tash Agjencioni i Pronave i Kosovës se prona nuk ka konteste. Nuk e mohon mundësinë që banesa të ketë qenë më herët edhe në pronësi të ndonjë gjenerali serb para luftës.
Kadri Veseli, që thotë se vetë është kujdesur që të mos blej në kryeqytet një pronë me konteste, si shef i SHIK-ut, ka një rrëfim edhe për procesin e transaksionit të pronave në Kosovë, e në regjionin e Prishtinës në veçanti.
Ish-shefi i SHIK-ut thotë se duke ndjekur elementë të sherbimeve inteligjente serbe, kanë rënë në gjurmë të tjetërsimeve të kundërligjshme të pronave, në veçanti në regjionin e Prishtinës, pas të cilave qëndronin këta elementë.
"Kam arsye të besoj se një pjesë e madhe e tjetërsimit të pronave në mënyrë të kundërligjshme janë bërë me ndihmën dhe implikimin e shërbimeve inteligjente serbe dhe elementeve të tyre. Ata, nuk përjashtohet se i kanë ndihmuar mashtruesit dhe sekserët e ndryshëm në Kosovë nëpërmjet dokumenteve juridike të lëshuara në Serbi para dhe pas luftës ne Kosovë. Vlerat e këtyre transaksioneve kanë qenë marramendëse, duke shtuar se këto mjete mund të jenë përdorur edhe për financimin e strukturave paralele serbe në Kosovë.

Ai thotë se në këtë proces, të tjetërsimit të kundërligjshëm të pronave shumë të vlefshme, si mashtrues e sekserë kanë qenë të kyçur edhe një numër i kosovarëve. Në interesimin tonë se në këto transaksione të dyshimta, a mund të ketë pasur edhe njerëz të luftës, ai shton "Ka pasur fatkeqësisht!", duke shtuar se asnjë grup nuk mbanë përgjegjësi nëse një pjestar i tij është kyçur në aktivitete kriminale.
Ai pretendon që nuk është vonë që tash të hapen këto raste, dokumentet bazë të të cilave sipas tij janë nëpër gjykata, te lëndët civile dhe në Agjencionin Kosovar të Privatizimit dhe insiston se duhet në menyrë juridike gjithsesi të hapen dhe të rivihet drejtësia në vend, duke përmendur trekëndëshin e keqpërdoruesëve në ketë proces palën serbe, përfshirë nivelin e lartë të institucioneve të tyre dhe shërbimeve të tyre inteligjente, por dhe palën kosovare, grupe të caktuara dhe sekserë, avokatë, gjykatës dhe zyrtarë të komunave.
Edhe pse pranon, që kanë pasur informacione për tjetërsime pronash në vlera milionëshe, nuk tregon se çka ka bërë me këto informacione. Thotë se ka pasur raste kur kanë ndërhyrë tërthorazi dhe kanë pasur sukses në pengimin e tjetërsimit të pronës shoqërore, nga niveli i kompetencave dhe pergjegjesive në rrethana të kohës, por nuk pranon që të flasë për raste konkrete.
Veseli, tash anëtar i PDK-së, thotë se nuk e di se si u vendos partia e tij në një pronë shoqërore në kohën e pasluftës, por pranon të rrëfejë për historinë e objektit ku tash operon kryesia e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e Ramush Haradinajt.
"Zona e Llapit menjëherë pas luftës pati vendosur në këtë ndërtesë Policinë e Ushtarake, dhe bashkë me ta më vonë u vendosën edhe njerëz të SHIK-ut për regjionin e Prishtinës. Pastaj erdhën dhe u vendosën njërëz të partisë së Haradinajt. Njerëzit e mij dhe ata të AAK-së kanë bashkë-jetuar në këtë ndërtesë për nja 7-8 muaj", thotë Veseli dhe mohon trillerin tashmë të famshëm që Haradinaj, sipas tij për të fascinuar fansat e vetë në publik me dhuntitë e tij të njohura, e ka nxjerr SHIK-un "me shkelma" prej kësaj ndërtese.
"Ramushi kishte hapur një kuzhinë të vogël për zyrtarët e partisë së tij dhe një kohë aty janë ushqyer edhe njerëzit e mi. Nuk ka pasur kurrë konflikte as verbale, aq me pak grushte, perkundrazi njerëzit e mij dhe të Ramushit në këtë ndërtesë njiheshin me vite dhe raportet kanë qenë më se normale.", thotë Veseli.
Sipas tij, SHIK-u, me një marrëveshje në mes të Ramush Haradinajt dhe Latif Gashit, atëherë njërit nga drejtorët e SHIK-ut, tash deputet i PDK-së, njerëzit e SHIK-ut u sistemuan tjetërkund dhe ndërtesa më në fund kaloi

krejt në duart e partisë së Haradinajt. Me shaka mbyll fjalinë duke shtuar se "...edhepse nuk shquheshim për gjera të tilla, sikur të vinte puna te grushtet e shqelmat, dihet se kush kë do ta nxirrte, duke shtuar se ajo as që kishte ndodhur as që do të mund të ndodhte në asnjë skenar në kuptimin e normalitetit dhe kolegialitetit human që ka ekzistuar mes tyre.".
Veseli ka thënë se agjencia që ai ka drejtuar nuk ka dashur që të numërohej kurrë si uzurpatore, prandaj edhe për zyrat e tyre që janë ditur publikisht, në rrugën "Garibaldi", afër Hotel "Grandit", ka paguar një qira simbolike në arkën e Ndërmarrjes "Trepça" deri në qershor 2008. Tash në këto zyra operon Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), i njohur edhe si "gjykata e tenderëve".
Veseli ka folur edhe për publikimin e një seri shkrimesh në media në vitin 2006, që njiheshin si "Dosja SIA" (SIA, në kuptim të "Sigurimi i Atdheut").
"Këto publikime, këto informacione nuk kanë pasur të bëjnë dhe as që janë dalë nga zyrat e SHIK-ut, as si produkt informativ as si plasim. Ato janë publikuar nga zyrtarë të PDK-së në atë kohë dhe për burimin e tyre duhet pyetur zyrtarët e kësaj partie në atë kohë. Ndërsa i pyetur për ekzistencën e kësaj organizate dhe ndonjë bashkëpunimi apo përplasje të mundshme, ai në menyrë mohuese tregon se nuk kanë pasur asnjë kontakt as përplasje me një organizatë të tillë, ndërsa flet për bashkëpunimin me organizata të tjera të tilla në Kosovë.
Në kuadër të bashkë-rëndimit të punëve për luftimin e elementëve të shërbimeve serbe në Kosovë dhe fenomeneve negative globale, si terrorizmi dhe krimi i organizuar, që sipas Veselit ka qenë ndër synimet kryesore të SHIK-ut, thotë se kanë zhvilluar një sërë takimesh me drejtuesin e Institutit për Hulumtime Politike Strategjike dhe të Opinioneve (IHPSO), Ramë Maraj. Maraj kishte shërbyer edhe si këshilltar i ish-presidentit Ibrahim Rugova, ndërsa në masën e gjerë nuk njihej si drejtues i IHPSO-së, por si shef i organizatës 'Sigurim i Atdheut", ekzistencën e së cilës më vonë e mohoi edhe vetë Maraj.
Megjithëse takimet me Marjan dhe përfaqësuesit e Veselit ishin mbajtur, sipas Veselit, për afro dy vite, një bashkim praktik i tyre dështoi, por ata vazhduan të operonin ndaras. Nuk tregon të kenë pasur përplasje për operacionet që ka zhvilluar njëra- tjetra agjenci, por thotë se pas negociatave të gjata kanë hedhur firmat në një dokument me Marajn.
Veseli beson që do të "rrnojë" edhe mjaft vite, dhe nuk i bëhet vonë për të kundër reaguar, duke besuar se e vërteta vetëm sa mund të vonojë, por se ajo për ato realitete të veprimit të tyre do të dalë në shesh dhe të gjithë në këtë jetë do të mbesin ata që vërtetë kanë qenë. Nga ky kendevështrim thotë se tash për tash nuk e sheh të arsyeshme të flasë për detaje dhe për emra, por

beson se populli yne është mjaft i mençur për të njohur dhe dalluar bijtë e vetë dhe të vertetën nga gënjeshtra. Beson po ashtu që me SHIK-un ka bërë një punë të mirë në shërbim të vendit, dhe në të njëjtën kohë pret që edhe me aktivitetet politike ta bëjë të njëjtën.

Për krejt ata që flasin për krime, korrupsion e shpërdorime të detyrës, ka vetëm një këshillë: "Denonconi ato që i dini në prokurori, ose ato vendore, ose në rast që nuk ju besoni atyre, dërgojini denoncimet në EULEX. Është obligim i kosovarëve, dhe më së shumti i kosovarëve ta luftojnë, denoncojnë dhe denojnë krimin dhe kriminelët që po tentojnë të na mbysin të tashmën dhe të ardhmën e femijëve tanë", thotë Veseli

Ai ka shtuar se duhet të ndërpritet praktika e shëmtuar e akuzave verbale dhe guximi qyqar dhe i papergjegjeshëm i luftës së të gjithëve kundër të gjithëve, për t'u zëvendësuar me guxim dinjitoz të denoncimit dhe deshmimit në organe legjitime dhe legale të fenomeneve negative

I pyetur se për krejt ato që i thotë, a posedon dokumente të arkivuara SHIK-u, Veseli përsërit tashmë përgjigjen e tij të njohur: "Nuk ka pasur dokumente, por informacione", dhe thotë se ato janë këtu (duke drejtuar gishtin në kokën e tij).

Prishtinë, 9 janar 2013